

L I G J
Nr.7814, datë 14.4.1994

PËR MOSGARANTIMIN NGA SHTETI TË KREDIVE QË JAPIN BANKAT E NIVELIT TË DYTË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Për kreditë që bankat e nivelit të dytë u japin subjekteve të ndryshme shtetërore a private, Këshilli i Ministrave ose ndonjë institucion tjetër shtetëror nuk lëshojnë garanci për detyrimet që rrjedhin nga këto kredi, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj të veçantë.

Neni 2

Ndalimi i dhënies së garancisë, sipas nenit 1 të këtij ligji, përfshin mosgarantimin e shumës bazë të kredisë, si dhe atë për pagesën e interesave përkatëse.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.828, datë 20.4.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.